



UNMIK



IPVQ

---

**INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA**

**QEVERIA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO - VLADA KOSOVA**

**MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE  
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE  
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE**

Në përputhje me nenin 1 paragrafi 1.3 pika (ç) të Rregullores nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë,

Duke marrë parasysh rëndësinë e identifikimit të dokumentacionit të MPMS-së përmes vulës katrore dhe të rumbullakët,

Me qëllim të përkujdesjes permanente dhe të përdorimit të përgjegjshëm të vulave të MPMS-së Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale nxjerr këtë:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 11/2005  
PËR  
FORMËN, PËRMBAJTJEN DHE PËRDORIMIN E VULAVE TË MINISTRISË SË  
PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE**

**Neni 1**

**Qëllimi i nxjerrjes së Udhëzimit Administrativ**

1) Me këtë Udhëzim Administrativ rregullohet dhe përcaktohet forma dhe përmbajtja e vulave të MPMS-së, përdorimi i tyre, ndryshimi, ruajtja, asgjësimi si dhe çështjet e tjera përkitazi me vulat e kësaj Ministrie, në përputhje me Ligjin e aplikueshëm dhe aktet nënligjore të MPMS-së.

**Neni 2**

1) Për të dëshmuar vërtetësinë e akteve zyrtare, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në fushëveprimin e vet përdor vulën e rumbullaket dhe vulën katrore të pranimit dhe të dërgimit,

2) Përmbajtja e vulës së rrumbullakët dhe vulës katrore të pranimit dhe dërgimit të MPMS-së është identike në gjuhën shqipe, angleze dhe serbokroate.

### Neni 3

1) Vula e rrumbullakët dhe vula katrore e MPMS-së të cilat përdoren në nivelin qendror të kësaj Ministrie duhet të kenë këtë përmbajtje: **INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES NË KOSOVË - MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE,**

2) Vulat të cilat i përdor Agjencioni Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës do të kenë këtë përmbajtje: **IPVQ - MPMS - Agjencioni Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës,**

3) Përmbajtja e vulave të cilat i përdorin Departamentet e MPMS-së duhet të jenë: **IPVQ - MPMS** dhe emërtimi i saktë i Departamentit i cili e përdor vulën,

4) Vulat e përdorura nga institucionet vartëse të Departamenteve të MPMS-së duhet të kenë këtë përmbajtje: **IPVQ - MPMS**, shkurtesën e Departamentit përkatës dhe emërtimin e plotë të institucionit vartës të Departamentit.

### Neni 4

1) Vulat e MPMS-së sigurohen me urdhrin e Ministrit përmes Sekretarit të Përhershëm të kësaj Ministrie,

2) Ndërrimi apo asgjësimi i vulave të MPMS-së po ashtu, bëhet me urdhrin e Ministrit përmes Sekretarit të Përhershëm.

### Neni 5

1) Sekretari i Përhershëm i MPMS-së duke konsultuar Ministrin, me vendim të veçantë do të caktojë nëpunësin e autorizuar në nivel të MPMS-së për mbajtjen dhe përdorimin e vulave të kësaj Ministrie,

2) Përveç nëpunësit të autorizuar për mbajtjen dhe përdorimin e vulave në nivelin qendror të MPMS-së, Sekretari i Përhershëm i MPMS-së, në njësitë e tjera organizative të MPMS-së përmes Drejtorëve të Departamenteve të MPMS-së mund të autorizojë nëpunës të tjerë për mbajtjen dhe përdorimin e vulave,

3) Vulat e MPMS-së mund t'i përdorin edhe institucionet vartëse të Departamenteve të kësaj Ministrie, siç janë: Qendrat për Punë Sociale, Zyrat Rajonale dhe Komunale të Administratës

Pensionale, Zyrat Rajonale dhe Komunale për Punësim, Qendrat për Aftësi Profesionale dhe Institucionet e tjera të cilat i mbikëqyr dhe kontrollon MPMS-ja.

### **Neni 6**

- 1) Personi zyrtar i autorizuar, të cilit i besohet mbajtja dhe përdorimi i vulave të MPMS-së, është përgjegjës që vulat t'i ruajë dhe përdorë në përputhje me dispozitat ligjore,
- 2) Personat zyrtar të cilëve iu besohet mbajtja dhe përdorimi i vulave të MPMS-së caktohen me vendim të veçantë të nxjerrë nga Sekretari i Përhershëm i MPMS-së.

### **Neni 7**

- 1) Çdo përdorim i vulave të MPMS-së nga personat jo kompetent dhe të paautorizuar do të sanksionohet sipas Legjislacionit të aplikueshëm,
- 2) Çdo keqpërdorim i vulave nga nëpunësi i autorizuar për mbajtjen dhe përdorimin e vulave të MPMS-së do të sanksionohet sipas Legjislacionit të aplikueshëm.

### **Neni 8**

- 1) Vulat e MPMS-së për të dëshmuar vërtetësinë e aktit, duhet të vendosen në të gjitha aktet e Ministrisë, me kusht që këto akte të jenë të nënshkruara nga personat përgjegjës dhe të autorizuar, si dhe të jenë të destinuara për komunikim zyrtar me institucionet e vendit apo ato ndërkombëtare.

### **Neni 9**

- 1) Humbja e vulave të MPMS-së apo asgjësimi i tyre duhet të shpallen si të pavlefshme në Gazetën Zyrtare të Kosovës,
- 2) Vulat e MPMS-së të cilat për shkaqe të ndryshme hiqen nga përdorimi, duhet që me komision të veçantë të asgjësohen, për të cilat përpilohet procesverbali mbi asgjësimin e tyre.

### **Neni 10**

- 1) Forma, përmbajtja dhe mënyra e përdorimit të vulave në MPMS mund të ndryshohen me rastin e aprovimit të Ligjit mbi Përdorimin e Vulave në IPVQ-të e Kosovës.

## **Neni 11**

1) Për të konfirmuar përdorimin e saktë dhe të drejtë të vulave të MPMS-së, nëpunësit e autorizuar për mbajtjen dhe përdorimin e vulave, brenda afatit prej dhjetë (10) ditësh pas nënshkrimit të këtij Udhëzimi Administrativ, duhet t'ia dorëzojnë Sekretarit të Përhershëm të MPMS-së të gjitha vulat ekzistuese.

## **Neni 12**

1) Pas hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ me përmbajtjen e këtij akti duhet të informohen të gjitha strukturat organizative të MPMS-së.

## **Neni 13**

1) Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi, ditën e nënshkrimit nga Ministri i MPMS-së.

**Prishtinë, tetor 2005**

**Ministri i MPMS-së  
Ibrahim Selmanaj**

---